



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATE/A:	28.01.2016
REFERENC-Ë:	AKK-DPK 03-02-4948/15
PËR/ZA/TO:	z. Arben Limani – Drejtor i Sekretariatit Ekzekutiv të Bordit të Drejtorëve – Agjencia Kosovare e Privatizimit
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Hasan Preteni, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me ofrimin e këshillimit profesional për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin të funksionit publik



I nderuari z. Limani,

Lidhur me kërkesën tuaj të pranuar në Agjencinë kundër Korrupsionit (DPK 03-02/4948/15), ju njoftojmë se në kuadër të kompetencave të Agjencisë kundër Korrupsionit lidhur me konfliktin e interesit, sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (LPKI), Agjencia bënë *“këshillimin e zyrtarëve të lartë të veçantë, të eprorëve, të institucioneve eprore, me kërkesën e tyre, për raste të caktuara të shfaqjes së konfliktit të interesave, dhe për çështje të etikës të lidhura me to, si dhe për regjistrimin rast për rast të interesave”* (Neni 19, pika 1.5 e Ligjit nr. 04/L-051)

Në kërkesën tuaj drejtuar AKK-së, për sqarimin të konfliktit të interesit, ju keni sqaruar se Bordi i Drejtorëve të AKP-së është emëruar me datë 17.12.2015, ndërsa njëri ndër anëtarët e Bordit (Ranko Djokic) është i punësuar në ndërmarrjen shoqërore Trepçë – Ndërmarrje nën Administrimin e AKP-së, si Asistent për çështje ligjore i Drejtorit të Trepçës Veri.

Bashkë me kërkesën ju keni ofruar vendimin e Kuvendit për emërim të anëtarëve të bordit, kërkesën për inicim të rastit nga z. Djokic, kontratën e tij të punës dhe Ligjin e AKP-së, së bashku me amandametimet përkatëse.

Bazuar në shkresat e lëndës dhe pas takimit që kemi pasur me ju, iu informojmë se kjo situatë është e rregulluar me Ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (nr. 04/L-051).

Ky ligj ka paraparë veprimet e ndaluara për zyrtarët e lartë. Në nenin 9, pika 1.7., përcaktohet se zyrtarit të lartë, gjatë ushtrimit të funksionit publik, i ndalohet *“të shfrytëzojë informatat e besueshme që i ka në dispozicion apo të marra në mirëbesim në ushtrimin e funksionit për përfitime personale apo për përfitime të personave të afërt apo te besueshëm”*.

Po ashtu, ky ligj ka paraparë se çka është konflikti i interesit dhe në cilat raste mund të paraqitet. Në nenin 6 përcaktohet se: *“konflikti i interesit është gjendja e mos pajtimit ndërmjet detyrës publike dhe interesave private të zyrtarit të lartë, kur ai ka interesa private të drejtpërdrejta ose të tërthorta, personale ose pasurore, te cilat ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në ligjshmërinë, transparencën, objektivitetin dhe paanësinë e tij gjatë ushtrimit të funksionit publik”*.

Ndërsa në mënyrë më specifike këtë situatë e kanë rregulluar dispozitat e nenit 13 të këtij ligji, në të cilat është paraparë konflikti *“rast për rast”* i interesit.

Pika 1 e nenit 13 përcakton se: *“çdo zyrtar i lartë gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vet deklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij private lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhen shkak për lindjen e një konflikti të interesit*.

Andaj deklarimi dhe tërheqja nga mbledhjet e Bordit të AKP-së sa herë që diskutohet dhe merret ndonjë vendim për Trepçën, mund të cenojë edhe vetë thelbin e detyrës së këtij anëtar dhe mund të shkaktoj probleme në funksionimin, kuorumin dhe vendimmarrjet e Bordit.

Po ashtu, kjo situatë bie në kundërshtim me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115.

Neni 2 i cili e ka riformuluar nenin 12 të Ligjit bazik, ka paraparë përbërjen e Bordit si dhe personat që nuk mund të mbeten anëtar të këtij Bordi. Pika 5 e kësaj dispozite, ndër të tjera përcakton se: *“Asnjë person nuk mund të bëhet ose të mbetet Drejtor nëse: ka interes apo pretendim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në apo kundër një ndërmarrje ose në një person apo subjekt i cili pretendon apo pohon një interes apo pretendim”*.

Andaj, bazuar në këtë dispozitë, z. Djokic nuk mund të ushtroj funksionin e Asistentit për çështje ligjore të Drejtorit të Trepçës Veri dhe njëkohësisht të jetë Anëtar i Bordit të AKP-së.

Në këtë situatë, bazuar në dispozitat e lart cituara, z. Djokic duhet të heqë dorë nga njëri funksion publik.

Me respekt!